

Në bazë të nenit 2 të Ligjit për taksat lokale komunale (“Fl. zyr.MZ”, nr. 27/06), nenit 45, paragrafi 1, pika 8 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe nenit 43 të Statutit të Komunës së Ulqinit (“Fl. zyr. MZ”, – dispozitat e komunës nr.5/07), Kuvendi i Komunës së Ulqinit në mbledhjen e mbajtur, më __. __. 2015 ka nxjerrë

VENDIMIN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR TAKSAT LOKALE KOMUNALE

Neni 1

Pas nenit 7 të Vendimit për taksat komunale (“Fl. zyr. MZ”, – dispozitat e komunës nr.19/09) shtohet neni i ri 7a që është: “taksapaguesi është i obliguar që organit të administratës lokale kompetent për çështje të të ardhurave lokale t’i paraqesë lajmërimin për fillimin dhe kohëzgjatjen e shfrytëzimit të objekteve, drejtave dhe shërbimeve nga neni 3 i këtij Vendimi.

Në rastin e ndryshimeve të rëndësishme për caktimin e obligimit tatimor, tatimpaguesi është i obliguar të njoftojë organin **nga paragrafi 1 i këtij Vendimi**.

Njoftimi bëhet në formularin “Paraqitja e taksës” i cili është pjesë përbërëse e këtij Vendimi që tatimpaguesi i merr tek organi, nga ueb faqja zyrtare e Komunës së Ulqinit ose në ndonjë mënyrë tjetër.

Neni 2

Në nenin 12 të Vendimit **në vend të fjalëve**: “nga dhjetëfishi deri njëzetfishi i pagës minimale në Republikë” **shtohen fjalët** “njëqind e pesëdhjetë deri në pesëmijë Euro (150 – 5000) për personat juridikë dhe sipërmarrësit.

Në paragrafin 2 të të njëjtit nen fjalët: “nga njëfishi deri në dhjetëfishin e pagës minimale në Republikë” zëvendësohen me fjalët: “nga pesëdhjetë deri në pesëqind Euro (50 – 500)”.

Neni 3

Në nenin 13 fjalët: “nga dhjetëfishi deri në dy qindfishi i pagës minimale në Republikë” zëvendësohen me fjalët: “nga pesëdhjetë deri në njëmijë Euro (50 – 1000)”.

Në paragrafin 2 të nenit të njëjtë **në vend të fjalëve**: “njëfishi deri dhjetëfishi i pagës minimale në Republikë” **shtohet**: “pesëdhjetë deri pesëqind Euro (50 – 500)”.

Neni 4

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e tetë pas botimit në “Fletoren zyrtare të Malit të Zi – dispozitat e komunës”.

Numër: _____
Ulqin, më __. __. 2015

KUVENDI I KOMUNËS SË ULQINIT

Kryetari

Mr. Fuad Haxhibeti

Arsyetim

Mbështetja juridike për nxjerrjen e këtij Vendimi është në nenin 2 të Ligjit për taksat lokale komunale me të cilin është paraparë që taksat lokale komunale i futën vetëqeverisja lokale me dispozitat e veta dhe që të ardhurat prej tyre i takojnë Buxhetit të Komunës së Ulqinit, me nenin 45, paragrafi 1, pika 8 e Ligjit për vetëqeverisjen lokale me të cilin është caktuar e drejta e Kuvendit të Komunës që të fustë taksat e komunës dhe kompensimet si dhe me nenin 43 të Statutit të Komunës së Ulqinit me të cilin është paraparë se cilët akte i nxjerrë Kuvendi.

Arsyet për nxjerrjen e këtij Vendimi janë harmonizimi i dispozitave ndëshkuese me Ligjin për kundërvajtje dhe fakti që edhe krahas së obligimit të caktuar të njoftimit, vendimi i mëhershëm nuk e ka pasur tekstin „paraqitja e taksës“.

Me këtë Vendim janë rregulluar çështjet nga paragrafi i mëparshëm i këtij arsyetimi në formën e forcës ekonomike dhe fiskale të subjektit – tatimpaguesit.

Për realizimin e këtij Vendimi nuk janë të domosdoshme mjete të posaçme financiare.

SEKRETARIATI PËR FINANCA DHE BUXHET